

Akt Themelimi

I shoqërise tregtare "AMAR 13" SH.P.K.

Mbeshtetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lire dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit", të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Q.K.B dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nenshkrimin e këtij akt-themelimi, unë themeluesja Z. Alketa Kazazi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "AMAR 13" SH.P.K. me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Sot me datë 21/04/2022, formohet shoqëria tregtare private e quajtur "AMAR 13" SH.P.K. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë seline dega. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në baze të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane Kavaje KAVAJE Lagjia nr 3, Rruga "Moisive", Objekt 1-katesh, Zona Kadastrale nr. 8552, Pasuria nr.4/38

Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Bar kafë. Import eksport e tregtimin me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshëm industriale të përdorimit të gjere, ushqimore të ndryshme, fruta-perimeve, pajisje elektroshtepiake, hidrosanitare, materiale ndertimi, arikuj mobilerie, për mobilime zyresh etj.

Kohezgjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkakut.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë) Lekë.

1. Ortaku themelues Z. Alketa Kazazi: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000(Njeqind mije) leke ne para, që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratoret Z. Alketa Kazazi,te cilet do te jene dhe perfaqesuesi ligjore i saj. Ato jane perfaqesuesit e Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe kane kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej Tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posaçme.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve.

Neni 8

Ortaket kane te drejte te emerojne dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Kane te drejte te caktojne financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Kavaje.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "AMAR 13" SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket.

Ortaku themelues

Zj. Alketa Kazazi

Alketa Kazazi
